ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA PODUJEVË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr[1] i prokurimit	**615-25-804-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Asfaltimi i rrugës Llapashticë-Popovë**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Rahovica Comerce shpk
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)
Rr.Ahmet Kaqiku pa nr.
(Adresa)
Ferizaj _____ _____
(Vendi) *(Kodi postar)*
049-120-969 _____ _____
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*
Fehmi Krasniqi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
rahovicashpk@gmail.com
(Adresa elektronike)
02.07.2025 _____ _____
(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

SH.P.K. RAHOVICA COMERCE NUI: 810165903 FERIZAJ

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi per kontrate: 12.02.2025
- Hapja e ofertave 26.03.2025 Ora 13:00
- Vendimi AK 18.06.2025
- Kerkesa për ri shqyrtim - 21.06.2025
- Vendmi i AK-se, Refuzimi i kerkeses – 24.06.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

- Hapja e ofertave 26.03.2025 Ora 13:00

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Operatori Ekonomik, ankues "Rahovica Comerce" shpk, me datën 21.05.2025, ka parashtruar kerkese për i shqyrtim ne autoritet kontraktues, ku kemi prezantuar fakte dhe dëshmi lidhur me shkeljet ligjore te konsumuara nga AK – Komuna Podujeve dhe pavaresisht kesaje AK, me vendmin e datës 24.05.2025, le ne fuqi vendmin e saje dhe pretendon te lidhe kontrate me kompani e cila është e pa pergjegjeshme ne aspekt administrativ, financiar dhe teknik.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

<u>Dispozitat e shkelura te LPP nr. 04/L-042 i amadamentuar:</u>

- Neni 7 – Barazia ne trajtim / jo diskriminimi
- Neni 25 Trajnimi i Zyrtareve të Prokurimit
- Neni 27 Dosja e Tenderit
- Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 69 – Kapaciteti teknik/profesional
- Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
- Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarreevshjeve
- Neni 130 Ndikimi i Paligjshëm

<u>Rregullorja nr. 001/2022, për Prokurim Publik</u>

- Neni 4.3 i rregullores 01/2022 per Prokurim Publik
- Neni 17.17 i Rregullores 01/2022 per Prokurim Publik
- Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 97 shkeljet e renda.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar,

Me date 18.06.2025 AK - Komuna Podujevë, ka publikuar, njoftimin mbi vendimin e AK – formualrin B58, per aktivitetin e prokurimit me titull: "*Asfaltimi i rruges ne Llapashtice – Popove*", me nr. 615-25-804-5-1-1, ku është rekomanduar për dhenien e kontratës kompania e pa pergjegjeshme ne aspekt administrativ, financiar dhe teknik, si rrjedhoje ne si OE te demtuar bazuar ne nenin 108/A te LPP-se, kemi parashtruar kerkese për ri shqyrtim kemi prezantuar fakte dhe prova për veprime kundërligjore dhe pavaresisht kesaje AK, me vendimine datës 24.05.2025, ka lejuar te procedohet me tutje me aktivitet te prokurimit, andaj bazuar nenenin 109, te LPP-se paraqesim faktet dhe provat sipas pretendimeve ankimore te poshte pershkruara:

Pretendimi ankimore: 1

Për këtë procedure te prokurimit autoritet kontraktues pervecse se ka rekomanduar për dhenien e kontratës kompani te pa pergjegjeshme ka shkelur proceduren e prokurimit dhe rregullat tjera nen ligjore për prokurim publik, pasi qe hapja e ofertave është realizuar me datën 07.04.2025, ndërsa publikimi i vendmit te AK-se – formulari B58, njoftimi mbi vendimin është publikuar me datën 18.06.2025, apo me shume se 2 muaj pas hapjes se ofertave.

Me nenin 59, lidhur me nenin 40, te Udhëzuesit me nr. 001/2022, për prokurim publik, paragrafi 3 percaktohet:

"*Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe* ***jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave****. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh...*".

Qe nga data e hapjes se ofertave deri me datën kur eshte publikuar njoftimin mbi vendmin e AK-se kane kaluar mbi 70 dite, perderisa dispozitat ligjore percaktojne se vleresimi i ofertave nuk mund te zgjas me shume se 30 dite ne afatin e rregullt dhe nuk mund te zgjatet me shume se 20 dite ku ju si autoritet kontraktues e keni shkelur edhe afatine rregullt edhe afatin e jashte zakonshem dhe fare nuk keni nxjerre vendim për shtyerjen e afatit te vlereimit te ofertave.

Te gjitha këto shkelje te afateve ne çdo pikepamje kane pasojne për kompanite, si ne vazhdim sigurimit te validitetit dhe qeshtje tjera. Pavaresisht tejkalimit te te gjitha afateve ligjore për ti vleresuar ofertat Autoritet Kontraktues, ka rekomanduar për dhenien e kontratës kompani te pa pergjegjeshme ne aspektin financiar dhe atë administrativ dhe me rekomandimin e tille eshte konsumuar shkele ligjore te shumefishta.

Me nenin 59, te LPP-se, gjegjesisht paragrafin 1 percaktohet kjarte se secili anetare i komisionit vleresues është përgjegjës individualisht për vleresimin e ofertave, perderisa sipas paragrafit 4 percaktohet se nuk mund te kualifikohet e pergjegjeshme oferta e cila nuk është ne perpuethshmeri me kerkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate.
Komisioni vleresues i ofertave ne raport te vlerësimit ka potencuar se oferta e OE, te propozuar

për dhënie ka devijime te vogla por se nuk është përcaktuar asnjeri devijim i cili është trajtuar si i vogel. Perkundrazi oferta e propozuar për dhënie te kontratës ka devijim te madhe dhe ne asnje rrethane nuk do te kund te kulaifikohej si e pergjegjeshme. Është nderhyre ne paramas dhe ne parallogari është eleminuar pozicioni dhe pershkrimi i AK-se.

Prove: Pjese nga raporti i vlerësimit te ofertave.

IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Nr:	Grupi:		
1	Asfaltimi i rrugës Llapashticë-Popovë		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	Kodi postar	Adresa
	Grup i Operatorëve Ekonomik FS C ING SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K.	11000	Haxhi Sadria

DEKLARATË

Komisioni i vlersimit pas analizimit dhe verifikimit te dokumentave te OE duke u bazuar ne nenin 59, paragrafi 4. pika (ii), te LPP-se si dhe ligjeve tjera ne fuqi, komisioni vlereson se oferta e OE përmban devijime te vogela te cilat nuk shkaktoja ndryshime materiale ose devijime ne karakteristikat ne kushtet e parashtruar ne njoftimin per kontrate dhe DT, andaj propozojm se Grup i Operatorëve Ekonomik FS C ING SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K.. te shperblehet me kontrate

Pretendimi ankimore 2

Autoriteti Kontraktues – Komuna Podujeve, zyrtaret përgjegjes te prokurimit dhe secili anetare i komisionit vleresues te ofertave, pavaresisht se keni konsumuar mbi 70 dite për ti vleresuar ofertat, jane shkelur edhe parimet kryesore te prokurimit publik me rastine peropozimit te ofertës se OE te propozuar për dhenien e kontratës, si rrjedhoje pergjate vlerësimit te tejezgjatur te ofertave ju si AK, eshte kerkuar sqarim nga kompania e propozuar për dhenin e kontratës lidhur me pozicionet e paramases te cilat janë eleminuar dhe janë larkuar, përkatësisht është nderhyre për qellim te caktuar mos realizimin e pozicionit.

Me nenin 59.4 te LPP-se veprimet e tilla tregojne për ndyshim material te ofertës dhe veprime kundërligjore te teresishme te AK-se.

Ne paramasen e Operatorit Ekonomik "FSC Ing" shpk ne pozicionin 8.00 "Sinjalizimi Horizontal", është fshirë apo larguar specifikimin teknik i paramases ku thuhet:

Vërejtje: Ngjyra duhet të jetë mase plastike e ftoftë dy komponenteshe (termoplastike) me rruaza qelqi dhe agragate kunder rreshqitjes, me trashesi te ngjyres ne siperfaqe mbi 3 mm, me koeficient te ndriçimit te retrorefleksionit gjatë natës (thate) i klasit min R3≥150 mcd, ne lagështi Rë3 35 mcd, koeficient te ndriçimit gjatë dites min. B3, β ≥0.4, koeficient te ndriçimit në ndriçimin difuz Q2≥100 sipas IS EN 1436, rezistenca ndaj rreshqitjes klasit S2≥50. Ngjyra duhet ta kete certifikaten e qendrueshmerise sipas standardit UNE – EN 1436:2009 + A1:2009.
Ky specifikacion vlen për të gjtha pozicionet e mësiperme të sinjalizimit horizontal të rrugës.

- Prove: oferta financiare e OE te propozuar kunderligjeshem për dhenien e kontratës.

8.00	Sinjalizimi horizontal				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	
8.01	Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijave te bardha te plota (gjeresia 150 mm)	m'	19,446.00	€ 0.50	€
8.02	Furnizimi dhe punimi në rrugë me vija te bardha te nderprera (3+3+3 m, me gjeresi 150 mm), pjesa e ngjyrosur e rruges	m'	2,342.00	€ 1.00	€
8.03	Furnizimi dhe punimi në rrugë me vija te bardha te nderprera (1+1+1 m, me gjeresi 150 mm), pjesa e ngjyrosur e rruges	m'	199.00	€ 1.25	€
8.04	Furnizimi dhe punimi ne rrugë me shigjeta për lëvizje (me gjatesi 5.00 m)	copë	36.00	€ 5.00	€
					€

	Rekapitulimi i Infrastruktures	
1.00	Pershkrimi i puneve	
2.00	Punët e Demolimit	
3.00	Punët toksore dhe tamponit	
4.00	Punët e Betonit dhe Asfaltit	
5.00	Punët e Leshesave Gypore	
6.00	Punët e ndryshme	
7.00	Sinjalizimi Vertikal	
8.00	Sinjalizimi horizontal	
	Gjithsejt €	

Paramasa dhe parallogaria
Projektit Kryësor I murit mbrojtës "1" L=88m

SH.P.K. FS C ING PODUJEVË

2

8.00	Sinjalizimi horizontal				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	
8.01	Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijave te bardha te plota (gjeresia 150 mm)	m'	19,446.00	€ 2.00	€
8.02	Furnizimi dhe punimi në rrugë me vija te bardha te nderprera (3+3+3 m, me gjeresi 150 mm), pjesa e ngjyrosur e rruges	m'	2,342.00	€ 2.00	€
8.03	Furnizimi dhe punimi në rrugë me vija te bardha te nderprera (1+1+1 m, me gjeresi 150 mm), pjesa e ngjyrosur e rruges	m'	199.00	€ 2.00	€
8.04	Furnizimi dhe punimi ne rrugë me shigjeta për lëvizje (me gjatesi 5.00 m)	copë	36.00	€ 20.00	€
	Vërejtje: Ngjyra duhet të jetë mase plastike e ftoftë dy komponenteshe (termoplastike) me rruaza qelqi dhe agragate kunde trashesi te ngjyres ne siperfaqe mbi 3 mm, me koeficient te ndriçimit te retrorefleksionit gjatë natës (thate) i klasit min R3≥1 Rë3 35 mcd, koeficient te ndriçimit gjatë dites min. B3, β ≥0.4, koeficient te ndriçimit në ndriçimin difuz Q2≥100 sipas IS E ndaj rreshqitjes klasit S2≥50. Ngjyra duhet ta kete certifikaten e qendrueshmerise sipas standardit UNE – EN 1436:200 Kv specifikacion vlen për të gjitha pozicionet e mësiperme të sinjalizimit horizontal të rrugës.				
					€

- Paramasa dhe parrallogaria e publikuar nga AK – Komuna Podujeve me cmime sic kemi ofertuar ne me specifiken e vijave termoplastike

Paramasa me cmime e bashkangjitur nga ana jone ku kemi ofertuar me cmim 2.00 € per m gjatesi e deshmon me se miri dallimin e cmimit me OE e rekomanduar nga AK ku ne si OE kemi llogaritur qe te punojm vijat sipas kerkeses se AK ku pershkruan specifikimin teknik ndersa OE i rekomanduar nga AK ka dhene cmim mbi 50 % me lire se ne per faktin se nuk ka llogaritur qe te beje punen sic ka kerkuar AK

Paramasa e Operatorit Ekonomik te propozuar për dhenien e kontratës, ku ka ofertuar me cmim per 0.50 cent per m' gjatesi, ktu shihet qarte ne dallimin e cmimet se OE me vetedije te plote e kane larguar nga paramasa specifiken ku AK ka kerkuar qe vijat te jene me mase plastike te ftofte dy komponenteshe (termoplastike) dallimi i cmimit te ofruar nga ne dhe OE, si rrjedhoje veprimet e tilla janë te vetedishme dhe sqarimi i ofruar nga OE, pas kerkeses për sqarim fare nuk ka te beje me printim te paramases dhe se AK, me sqarimin e tille perkatesisht

propozimin e ofertës se tille ka konsumuar shkelje ligjore te cilat mund te kene pasoje ligjore ne procedure eventuale gjegjesisht lidhja e kontratës eventuale me oferët te tille qon ne keqperdorim dhe mashtrim ne prokurim publik i sanksionuar me nenin 415, te KPK-se.

Ndërsa me nenin 10, te Udhëzuesit me nr. 001/2023, për Prokurim Publik percaktohet ju si AK – Komuna Podujeve, komisioni vleresues i ofertave e keni patur te ndaluar te rekomandoni për dhënie te kontratës ofertën e tille:

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
Lista e çmimeve nuk është plotësuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
"...specifikimit teknike – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar...	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	28

Men nenin 4.3 i rregullores 01/2022 per prokurim publik percaktohet:

4.3 Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:
a. Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe me efektive.
b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paranë për Autoritetin Kontraktues.
c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial.
Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.
d. Objektivitet/Integritet/Sinqeritet – Të deklarohet çdo konflikt i interesit që afekton ose paraqet afektim të vendimit; Të refuzohen dhurata, mikpritje dhe benefit të çfarëdo lloji nga Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial, të cilat mund të paraqesin kompromitim të objektivitetit ose integritetit.
e. Transparenca – Të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente.
f. Llogaridhënie – Të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme.
g. Profesionalizëm – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.

<u>Pretendimi ankimore 3</u>

Operatori Ekonomik, i propozuar kunderligjeshem dhe me nderhyrje ne dokumente standarde te AK-se, ka edhe mangesi tjera lidhur me kerkesat e kapacitetit ekonomik dhe financiar si dhe me kerkesat e kapacitetit teknik dhe profesional nga neni 68 dhe 69 i LPP-se dhe nuk janë raportuar nga komisioni vleresues i ofertave, ku OE ne oferte nuk ka prezantuar ashtu siç është kerkuara, pervojen dhe kualifikimet e stafit kyq dhe kapacitetet e pajisjeve teknike adekuate me kerkesat e AK-se.

OE nuk i ka deshmuar te gjitha makineritë sipas kërkesës së dosjes së tenderit ku kerkohen qe paisjet te deshmon me DUD, librezan te qaekullimit rrugore dhe foto

- **Provë kerkesa ne dosje te tenderit**

Dëshmia Lista e paisjeve e nënshkruar dhe vulosur original nga OE, të dhënat e paisjeve, Librezat me validitet per makinerin që regjistrohet, Dud , Faturë, Foto per paisjet e tjera.

Pretendimi ankimore 4

Tek kerkesa e aneksit te makineris pika 6 Kerkohet **Kamion kiper me kapacitet min 20 m3** OE nuk ka ofruar deshmi sipas kerkeses se AK ku qarte thuhet kamion kiper me kapacitet min 20 m3, Operatori Ekonomik, ka ofruar koke terheqese me gjysmerimorkio kiper andaj edhe ne kete pike Operatori Ekonomik i propozuar për kontrate eshte i pa pergjegjshem pasi nuk i ka ofruar kapacitetet sic kerkohen ne DT.

Madje AK ne refuzimin e kerkeses per ri shqyrtim tek kjo pike ka thene

- **Në asnjë pjesë të DT-së nuk është përcaktuar se kërkohet "kamion rigid" (pra i ndërtuar si njësi e vetme), as nuk është përjashtuar përdorimi i mjeteve të përbëra (kokë tërheqëse + gjysmë rimorkio).**

Eshte skandaloze se si AK i percakton kriteret specifikisht ku specifikohet saktë "kamion kiper min 20m3" dhe pasi OE i preferuar deshton te sjell kapacitetin sipas kerkeses AK terhiqet dhe shtrembon faktin per te shperblyer OE te preferuar me kontratë duke mos i respektuar kriteret qe vet AK i ka vendosur kjo eshte mashtrim ne prokurim publik e cila sanksionohet me me kodin penal te shtetit.

Provat dhe deshmite e siper prezantuara tregojne se AK - Komuna Podujeve dhe zyrtaret pergjegjes te prokurimit kane shkelur parimet e prokurimit kane favorizuar kompan e propozuar per kontrate dhe me keto veprime jane konsumuar shkelje serioze ligjore, prandaj kerkojme nga OSHP, qe te autorizoi ekspert shqyrtues te pa aneshme, profesional dhe te pa ndikueshe, ne ate menyre qe sipas nenit 113 dhe 114, te LPP-se i trajton te gjitha pretendmiet ankimore dhe paneli shqyrtues te nxherre kete:

V E N D I M

I. **Aprovohet** ne tërësi e bazuar ankesa e OE "Rahovica Comerce" shpk – Ferizaj
II. **Anulohet,** vendimi – propozimi për dhenien e kontratës i datës 18.06.2025, si i kunderligjeshem dhe lënda kthehet ne **rivlersim,**
III. **Lejohet,** kthimi i mjeteve te deponuara ne emer te ankeses.

Shkeljet ligjore te sipër argumentuara konsiderohen si shkelje te renda te LPP-se dhe te percaktuara me nenin 97, te Rregullores me nr. 001/2022, për prokurim publik dhe kompania do te kërkojë te ndermirren edhe veprime tjera ligjore pasi qe ekzistojne prova dhe fakte reale për keqperdorim dhe mashtrim ne prokurim publik dhe nderhyrje ne formular standard ku për keso veprimesh ekzistone baza ligjore ekzistojne vendime te OSHP-se dhe interpretime te KRPP-se.

9. Dëmet materiale